



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 18.03. 2014, në orën 10.00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Kimete Bytyçi dhe Duda Balje

Të ftuar: Sami Salihu- drejtor i Departamentit të Pensioneve, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Leonora Zylfijaj-MPMS, Drita Hajdini-MPMS dhe Enver Kurtalani-Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës.

Nga Staf i mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Pjesëmarrës të tjerë: Nebih Preniqi-SHKSH, Lejla Selimi-OSBE, Ukë Gashi-ZRPK, Visar Bivolaku-EU OFFICE-EUSR, Selvete Krasniqi-GDNJD, Nuredin Ibishi- UNDP
Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 28 janar dhe 25 shkurt 2014;

3. Shqyrtimi i zbatimit të ligjeve

3.1 Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, respektivisht përjashtimi i personave të shurdhër nga skema pensionale, dhe

3.2 Ligji për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të

Përhershme, respektivisht mos përfshirja e familjeve të fëmijëve të shurdhër. I ftuar për këtë pikë është ministri i MPMS, z. Nenad Rashiq.

4. Shqyrtimi i peticioneve;

5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës,

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 28 janar dhe 25 shkurt 2014

Kryetarja konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 28 janar dhe 25 shkurt 2014, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i zbatimit të ligjeve:

3.1. Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, respektivisht përjashtimi i personave të shurdhër nga skema pensionale, dhe

3.2 Ligji për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të

Përhershme, respektivisht mos përfshirja e familjeve të fëmijëve të shurdhër. I ftuar për këtë pikë është ministri i MPMS, z. Nenad Rashiq.

Kryetarja- Tha se kemi pranuar një shkresë nga Shoqata Kosovare e të shurdhërve, ku jemi njoftuar se me një vendim të ministrisë janë përjashtuar nga skema pensionale, me arsye siç thuhet në ankesë, se te këta aftësia e përhershme e kufizuar nuk ekziston.

Për këtë arsye kemi ftuar ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale që t'i sqarojë këto konfuzione dhe për çfarë arsye kanë ra në konfuzion.

Si Komision na intereson se me çfarë arsye dhe me çfarë vendimi i keni larguar nga skema pensionale personat e shurdhër, kërkojmë përgjigjeje po ashtu për Ligjin për Përkrahje Materiale

Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, të njëjtit nuk janë përfshirë, a mendoni se do t'i përfshini, a keni në plan ndonjë nismë për plotësim ndryshim të këtij ligji?

Sami Salihu, drejtor i Departamentit të Pensioneve, MPMS- Tha se ftesën dhe rendin e ditës i kemi marrë me kohë, por unë personalisht nuk kam njoftim se është marrë ndonjë vendim prej ministrit apo dikujt tjetër, ekzaminimin e të gjithë personave që pretendojnë se janë me aftësi të kufizuara e bën komisioni profesional që është i pavarur në kuadër të MPMS.

Prandaj vendim për këtë nuk ka, vlerësimin se a është dikush me aftësi të kufizuara apo a duhet të jetë në skemën pensionale e bën komisioni mjekësor, ligji është për personat me aftësi të kufizuar të plotë dhe të përhershme, personat e shurdhër nuk janë me paaftësi të plotë ata mund të angazhohen të punojnë.

Enver Kurtalani, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve- Tha se është dobësi të thuhet se personat e shurdhër prej vitit 2004 paskan qenë persona me aftësi të kufizuara dhe tani nuk janë më. Kjo bie ndesh dhe nuk dihet se a e paskeni shkelur ligjin në atë kohë apo po shkelet tani, kur po i largoni. Kam sjellë dy shembuj që thuhet te ju, aftësia e përhershme e kufizuar nuk ekziston dhe kam konsultuar edhe konventën ndërkombëtare ku në nenin 1, paragrafin 2, thuhet: aftësia e kufizuar shqisore, ku hyjmë edhe ne, pra personat e shurdhër janë persona me aftësi të kufizuara. Shqetësimi i jonë është se prej vitit 2004 personat e shurdhër kanë marrë pensionin, kurse tani jo, atëherë kjo po i bie se ose atëherë kanë qenë komisionet në kundërshtim me ligjin ose janë tani, duhet kemi kujdes dhe mos të bëhen këto shkelje themelore të të drejtave të njeriut dhe si shoqatë duam të dimë kush ka marrë këtë vendim dhe në çka janë bazuar?

Kurtan Kajtazi- Pyeti se a ka persona me aftësi të kufizuara të cilët kanë certifikatën e komisionit mjekësor që kanë dëshmi se kanë aftësi të kufizuar të përhershme dhe që janë të refuzuar, dhe po më intereson të dijë numrin e saktë të personave me aftësi të kufizuara.

Enver Kurtalani- Tha se deri tash kemi 500-1000 lëndë që janë refuzuar, janë kthyer të njëjtat vendime, kurse përfitues nga pensionet kanë qenë 1500, audiogramet që tregojnë shkallën e dëgjimit të gjithë e kanë pasur, dhe audiogrami e tregon aftësinë dëgjimore tonën, dhe secili e ka dosjen në ministri, por këtu është një vendim që dikush e ka marrë m'i largu të gjithë këta, ata i kanë dosjet paraprake tani janë vetëm në rivlerësim.

Nebih Preniqi- Shoqata Kosovare e të Shurdhërve, tha se si përfaqësues i këtij komuniteti kam një shqetësim ndaj komisionit vlerësues, sjellja e tyre jo shumë profesionale, vlerësimi është bërë me metoda teknike jo të mira, me grushtime të tavolinave, kemi metoda me të mira dhe me profesionale të vlerësimit.

Kemi probleme dhe nga ky komunitet ka të martuar ndërmjet vete dhe kemi prindër që janë bartës të familjeve dhe janë varur vetëm nga ky pension, dhe asnjë person i shurdhër nuk është i punësuar në institucione për shkak të barrierave të komunikimit. Ne diskriminohemi sepse askush nuk na merr në punë për shkak të paaftësisë së komunikimit.

Sami Salihu- Tha se dyshoj që ka vendim të tillë, nuk po e mohoj se për raste individuale janë lëshuar vendime të tilla, por si institucion nga ana e ministrisë nuk ka një vendim të tillë që të përjashtohen këta nga skema pensionale.

Ai tha se të shurdhrit sidoqoftë kanë mundësi të punojnë, përveç atyre me aftësi të plotë të kufizuar.

Kryetarja- Tha se nuk pajtohet me arsyetimin e shkurtër që ju është dhënë me një fjali, aftësia e kufizuar e përhershme të këta persona nuk ekziston, është një arsyetim i mangët, dhe një personit që ka marrë pension deri në vitin 2014, a ju është kthyer dëgjimi, sepse atëherë kishte me pasur bazë kjo, sepse 10 vjet ka marrë pension.

Kurtan Kajtazi- Tha se në bazë të vlerësimit të Komisionit mjekësor mendoj se këtu nuk është fajtor ministria, ka respektuar ligjin, por fajtor mund të jetë vetëm ligji, sepse kur konstaton komisioni se nuk është aftësi e kufizuar e përhershme, ministria e ka të obliguar në bazë të ligjit me i ndalur. Ai tha se i intereson të dijë se a ka tani persona të shurdhër që marrin pensionin dhe sa është numri i tyre, me çfarë arsyetimi ata e marrin pensionin.

Enver Kurtalani- Tha se ka persona që marrin këtë pension dhe 1500 e kanë marrë, por tani 500 -700 prej tyre, i kanë marrë refuzimet. Ata që e marrin janë me arsyetim të komisionit vlerësues.

Albana Gashi- Tha se sa i përket rasteve të atyre 500 personave, a kanë përfituar me herët pensione këta persona, dhe për sa kohë kanë fituar?

Enver Kurtalani- Tha se këta persona kanë fituar pensione prej vitit 2004 e deri në vitin 2014, kur është bërë rivlerësimi.

Albana Gashi- Tha se drejtori i Departamentit të Pensioneve në MPMS, tha se ka mundur me pasur gabime të disa raste, si për lëshimin e pensioneve, si për refuzimin e kërkesave, por pyeti a thua komisioni paska gabuar në 500 raste, është e papranueshme nëse komisioni vepron në kundërshtim nga vendimet e ministrisë dhe Qeverisë, kjo është një punë që duhet hetuar.

Sami Salihu- Tha se në komision janë së paku 3 veta dhe nëse pala ka ankesë mund ta shfrytëzojë të drejtën e ankesës. Aplikim bëhet në qendrat rajonale me të afërta që i kanë,

vlerësimi bëhet në qendrat rajonale të përshtatshme, pala e pakënaqur me vendim ka të drejtë të bëjë ankesë në shkallën e dytë në Departamentin në Prishtinë, dhe në rast se prapë është e pakënaqur ka mundësi të bëjë padi në Gjykatën Themelore.

Kymete Bajraktari- Pyeti përfaqësuesit e ministrisë se në çfarë baze i keni nënshkruar këto vendime, në bazë të vlerësimit të Komisionit mjekësor dhe atë të 500-1000 lëndë blanko.

Kryetarja- Pyeti se çka i keni dhënë si dokumente përcjellëse palës, a ka pala provë pse është refuzuar, a i qitni të dhënat e komisionit mjekësor, a ka pala konstatim të mjekut, pra, a e ka pala diku të bashkëngjitur materialin përcjellës vlerësimin e komisionit vlerësues.

Rita Hajzeraj-Beqaj- Tha se arsyetimet e ministrisë konsideroj se nuk qëndrojnë. Ne i kemi faktet përpara, e kemi edhe ligjin edhe vendimet që janë nxjerrë, po ashtu dyshoj edhe në komisionin vlerësues, është dashur edhe ju si ministri me dyshuar në të, derisa është një numër aq i madh i refuzimeve të këtyre lëndëve. Ajo tha se komision vlerësues dhe ministria të mblidhen urgjent dhe me i shqyrtuar edhe njëherë këto kërkesa dhe pse ka ndodhur një refuzim kaq i madh i këtyre personave nga skema pensionale dhe pas kësaj pas disa dite me informuar komisionin pse ka ndodhur kjo?

Kymete Bajraktari- Tha se nuk pajtohet me atë që u tha se kanë aftësi të punojnë këta persona, se paraprakisht nëse ju gjendet një vend i përshtatshëm për punë, ata mund të punojnë, e paraprakisht dhe nuk ekziston ky arsyetim, sepse atëherë të gjithë personat me aftësi të kufizuara duhet përjashtuar nga skema pensionale.

Leonora Zylfijaj- Departamenti Ligjor i MPMS, tha se ky ligj ka për qëllim t'i japë pension personave të cilët janë plotësisht të pa aftë për punë. Kategoria e personave të shurdhër, vetë fakti që këta persona mund të punojnë, nënkupton se këta kanë aftësi të mbetura për punë, komisionet mjekësore që veprojnë në kuadër të MPMS, kanë mandat të shqyrtojnë kërkesat e personave të cilët janë 100% të pa aftë për punë dhe nëse ata konstatojnë se janë të pa aftë 100% për punë atëherë konstatojnë se ju takon edhe e drejta për pension, nëse nuk i plotësojnë kriteret atëherë këta persona nuk konsiderohen se kanë aftësi të kufizuar, ndodh 50% apo 60%, varësisht sa e përcakton komisioni mjekësor. Komisioni mjekësor konsideroj se e ka marrë për bazë mbetjen e shkalles së aftë për punë.

Kryetarja - Tha se është në pyetje pensioni i personit me aftësi të kufizuara, dhe kërkoj arsyetimet e plota nga komisioni se çka ka konstatuar për këto refuzime dhe provat se për çka janë refuzuar? Kërkoj nga shoqata të marrë të dhënat se nga cilat qendra dhe sa persona janë refuzuar, me intereson të dijë listën e saktë të refuzimeve.

Rita Hajzeraj- Pyeti shoqatën, se a kanë hyrë të gjithë këta persona në riekzaminim të komisionit mjekësor, dhe po ashtu tha se për ministrin është nenin 3, se si duhet të funksionoj edhe departamenti edhe komisioni, dhe nga kjo shihet se është shkelur ligji.

Enver Kurtalani- Po të gjithë këta persona sivjet ju kanë nënshtruar ri ekzaminimit, por përgjigjet janë kthyer të gjitha të njëjta.

Kryetarja- Tha se më 25 mars do të mbajmë mbledhjen e radhës së komisionit, dhe ju presim përsëri në Komision, dhe kërkoj të na sillni një regjistër, sa persona i keni refuzuar me emër dhe mbiemër dhe arsyetimet mjekësore pse janë refuzuar? Nga shoqata kërkoj të nxirret numri i saktë i të larguarve nga skema pensionale, po ashtu edhe nga ministria, dhe të shihet se a po përputhen të dhënat? Shoqata t'i evidentojë 10 raste që konsideron se janë refuzuar pa bazë dhe të sjellë edhe dokumentacionet mjekësore për to. Po ashtu ajo pyeti përfaqësuesit e ministrisë se a është duke punuar ministria për plotësim ndryshimin e ligjit të dytë që ju kemi cekur.

Sami Salihu- Tha se pajtohet që shoqata të sjellë listën dhe e kompletojë dokumentacionin, dhe në mbledhjen e radhës tha se do të vijë edhe një përfaqësues nga komisioni mjekësor, ndërsa sa i përket ligjit të dytë për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, respektivisht mos përfshirja e familjeve të fëmijëve të shurdhër, tha se nuk është duke u punuar.

Justina Pula-Shiroka- Tha se mund të ndodhë që në fillim kur është lajmëruar ky komunitet ka ekzistuar vullneti dhe ajo kulturë që kjo e drejtë të ju pranohet të gjithëve që janë paraqitur, prandaj dokumentet që do të na sillen është mirë të cekën se në cilën kategori kanë qenë atëherë këta persona dhe në cilën kategori janë tani, nëse kategoria është e njëjtë atëherë përgjegjësia bie në komisionin mjekësor, dhe të jepen sqarime pse atëherë ka pasur të drejtë me marrë pensionin e pse tani jo.

Kryetarja konstaton se Komisioni unanimisht vendosi të nxjerr këtë;

Përfundim

Në mbledhjen e radhës që do të mbahet më 25 mars 2014 të sillen komplet numri i të refuzuarve të këtyre personave nga skema pensionale, si dhe emrat dhe mbiemrat e tyre. Shoqata të përgatit 10 lëndë që janë refuzuar dhe po ashtu ministria të përgatit dokumentacionet komplet për to dhe të shqyrtohen në komision se a kanë pasur të drejtë përjashtimi nga skema pensionale apo jo?

4. Shqyrtimi i Peticioneve

Kurtan Kajtazi- Tha se kem një kërkesë nga një qytetar i cili ju ka drejtuar Kryeparlamentarit dhe Komisionit i cili e ka një vendim të Gjykatës së Qarkut, për mbrojtje të ligjshmërisë, si Komisioni në vendime të gjykatës nuk mundemi dhe nuk jemi kompetent të ndërhyjmë.

Kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime vendosi të nxjerrë këtë:

Përfundim

Komisioni nuk ka kompetencë të shqyrtojë dhe të ndërhyjë në lëndët të cilat i ka shqyrtuar apo janë në proces gjyqësor.

Kurtan Kajtazi- Tha se kemi edhe një kërkesë, Ilmi Gashi nga fshatit Studenqan, Komuna e Suharekës, që shpjegon se ka qenë pjesëmarrës nëpër demonstrata dhe në vitin 1989 në demonstrata është plagosur dhe kërkon një pension nga shteti, për sakrificën që ka bërë sepse 60 euro që i merr nga shteti thotë se nuk i mjaftojnë. Ai tha se dihet qysh është rregulluar skema pensionale për veteranet, invalidët dhe të tjerët, por është mirë me dërguar për shqyrtim edhe në Komisionin për Shëndetësi, pasi që ky person e ka humbur këmbën dhe me shqyrtuar se a ka mundësi për ndonjë trajtim të veçantë ky person.

Kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime vendosi të nxjerrë këtë:

Përfundim

Komisioni vendosi që këtë kërkesë ta dërgojë për shqyrtim në Komisionin kompetent për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale se a ka mundësi që t'i afrohet ndonjë trajtim i veçantë këtij personi.

5. Të ndryshme.

Kryetarja- Tha se Komisioni ka bërë monitorimin e ligjit për Avokatin e Popullit dhe Ligjit kundër diskriminimit dhe në këto monitorime jemi përkrahur nga OSBE, është

praktikë që mbas 6 muajve të miratimit të raportit të shikojmë se rekomandimet a po zbatohen nga ministritë përkatëse.

Unë kam qenë kryesuese e grupit punues për monitorimin e ligjit kundër diskriminimit dhe nëpër takime e tryeza që kemi pasur jam ne rrjedha se si ka shkuar procedura.

Por ne për këtë ligj mund t'ju drejtohem me një shkresë zyrës ligjore që të na informojë lidhur me rekomandimet e dala nga monitorimi i ligjit kundër diskriminimit.

Për monitorimin e ligjit për Avokatin e Popullit kryesuese e Grupit punues ka qenë Rita Hajzeraj dhe nga ne po kërkohet të mbahet një dëgjim publik dhe të marrim informacione se sa po zbatohen rekomandimet e miratuara.

Kryetarja tha se për datën e dëgjimit publik do të vendosim në mbledhjen e ardhshme sa i përket zbatimit të rekomandimeve për ligjin për Avokatin e Popullit.

Rita Hajzeraj- Tha se është e arsyeshme të mbahet dëgjimi publik dhe të ftohen institucionet involvuara në këtë proces dhe të shohim se sa janë zbatuar ato rekomandime dhe se çka mendohet të ndryshohet në këtë ligj nëse vjen ligji në plotësim -ndryshim.

Mbledhja përfundoj në orën 11:15.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali